

## NJOFTIM

### PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE SHTETERORE SIPAS VKM-së Nr.179, datë 26.02.2020

Në zbatim të VKM-së nr.179 datë 26.02.2020 ” Për Rregullat, Kushtet dhe Procedurat e Privatizimit të Banesave që kanë qenë subjekt i Ligjit nr.7652 datë 23.12.1992,”Për Privatizimin e Banesave Shtetërore”, dhe të ligjit nr.9321 datë 25.11.2004,”Për Privatizimin e Banesave dhe Objekteve të kthyer në Banesa, të ndërtuara me fondet e Shoqërive dhe të Ndërmarrjeve Shtetërore”,( i ndryshuar ) **njoftohen qytetarët** që posedojnë banesa ose objekte të kthyer në banesa të ndërtuara nga shteti, të cilat vijojnë të jenë në pronësi të shtetit e rezultojnë të paprivatizuara **kur këto banesa:**

a) kanë qenë objekt privatizimi sipas ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, por kanë mbetur pa u privatizuar nga familja që e ka poseduar me kontratë qiraje me ish-ndërmarrjet komunale banesa;

b) janë objekt privatizimi dhe janë banesa të ndërtuara deri më 31.12.1999 dhe që i kanë kaluar në administrim dhe/ose pronësi Entit Kombëtar të Banesave (në vijim, EKB) me akte nënligjore, sipas ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, “Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”.

c) kanë qenë objekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, dhe që, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, figurojnë në pronësi të shtetit, kryhet në emër të personit, i cili ka pasur kontratë qiraje me shtetin para vitit 1992 dhe të personave të tjerë madhorë të familjes, sipas certifikatës së gjendjes familjare të datës 1.12.1992. Kontrata e qirasë ose, në mungesë të saj, dokumente që vërtetojnë qiradhënien para vitit 1992.

d) janë objekte të kthyer në banesa, që kanë qenë objekt i ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, “Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore” dhe që, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, rezultojnë ende të paprivatizuara, bëhet në emër të personit/ave, që ka/në emrin në listën e trashëguar nga ish-ndërmarrjet shtetërore dhe të personave të tjerë madhorë të familjes, që bëjnë pjesë në certifikatën e gjendjes familjare të datës 1.12.2004. **të paraqesin brenda 90 ditëve kërkesën për fillimin e procedurave të privatizimit të banesës pranë Bashkisë Skrtapar nga:**

a- Subjekti i pajisur me autorizim nga organet kompetente, ose në rast vdekjeje të trashëgimtarëve të tij;

b- Çdo person i autorizuar me prokurë nga subjekti i përcaktuar më lart.

**Kërkesa e depozituar pranë EKB/njesisë së qeverisjes vendore duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:**

a) dokument që tregon se personi gëzon të drejtën e privatizimit të banesës, të tillë, si: kontrata e qirasë, akti i dhënies ose i marrjes në dorëzim të banesës nga ish-ndërmarrja komunale banesa ose autorizim nga ish-organet administrative publike që e kanë strehuar në atë banesë;

b) certifikatë e gjendjes familjare e datës 1.12.1992 dhe certifikatë aktuale të gjendjes familjare në momentin e privatizimit për efekt të përcaktimit të sipërfaqes së banesës që i takon familjes, bazuar në normat e strehimit në momentin e privatizimit dhe të përcaktimit të sipërfaqes së tepërt mbi normën e strehimit, nëse ka një të tillë;

c) dëshmi e trashëgimisë, nëse ka një të tillë

ç) prokurë, nëse ka një të tillë.

d) dokument identifikimi i kërkuesit (kartë identiteti dhe/ose pasaportë biometrike).

Faleminderit.